




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0069659/21-8.1 dt. 26.08.2021
Mitrovicë

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020

Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetjet	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1. Cështja A1 Shpenzimet e përmbartimit	Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPF, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.	Kryetari duhet të sqarojë se obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore me qëllim që mos të demtohet buxheti i kornesës me kosto shtesë të përrnbarlmit.	Gjatë vitit aktual, Komuna po përpiqet të kryejë në mënyrë sistematike obligimet e mbetura, me theks pagat jubilarë, në mënyrë që të shmangen këto shpenzime.	D.K.A., D.Shëndetshis, D.SH.P.I. D.F.ZH.E. dhe Drejtoritë tjera të involvuara në këto obligime dhe shpenzime.	Gjatë viteve vijuese.

	<p>Vlera e pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendime gjyqësore/përmbaremore ishte 1,746,868€, prej tyre borxhi kryesor ishte 1,568,180€ ndërsa 178,688€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbaremit. Pagesat kishin të bënin me paga jubilare, pagesa për shërbime, investime, etj.</p>				
<p>2. Çështja C1</p> <p>Vonesa në pagesën e faturave</p>	<p>Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës.</p> <p>Në pesë raste pagesat në vlerë 86,993€ ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh.</p> <p>Vonesat variojnë nga 55 deri në 174 ditë.</p>	<p>Kryetari duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre.</p>	<p>Kryetari ka bërë apel në takimin e drejtorëve që pagesat të kryhen të gjitha me kohë.</p>	<p>Të gjitha drejtoritë të cilat krijojnë shpenzime.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit</p>
<p>3. Çështja B1</p> <p>Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira</p>	<p>Sipas Ligjit 06/L-092 prona e paluajtshme e komunës mund të jepet në shfrytëzim për të gjithë personat fizik dhe juridik me një afat të caktuar. Sipas kushteve të kontratave, pagesa e obligimit duhet të bëhet deri me datën 05 të çdo muaji vijues. Në kontrata specifikohet se Kuvendi Komunal çdo 2 vjet, do të bëjë rivlerësimin e</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se janë ndermarre veprimet e duhura ligjore që pronat e shfrytëzuara nga personat privat dhe juridik të rikthehen nën kontroll të komunes, ose të behet ripërtirja e kontratave, në mënyrë</p>	<p>Këtë rekomandim do të mundohemi ta implemetojmë gjatë viteve vijuese për arsye se rasti i banesave për kuadro është në Gjykatë, kurse banesat për raste sociale për shkak</p>	<p>Kryetari i Komunës dhe DPU.</p>	<p>Gjatë viteve vijuese.</p>

	<p>gjendjes ekonomike të familjeve, me qëllim të vazhimit/ndërprerjes së vlefshmërisë së kontratës. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.</p>	<p>qe komuna te arketoje te hyra nga dhenia ne shfrytezim e pronave.</p>	<p>të gjendjes ekonomike dhe rrethanave tjera jemi të kufizuar për të vepruar.</p>		
<p>4. Çështja A2</p> <p>Mos azhurnim i planit të menaxhimit të kontratave</p>	<p>Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ i prokurimit publik, pika 61 – Menaxhimi i kontratës, dhe pikat 61.7 dhe 61.20 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës (MK) në menaxhimin e kontratave publike. Menaxheri i kontratës duhet të sigurojnë se Kontrata po realizohet në përputhje me kushtet kontraktuale. Po ashtu në pjesën III të kontratës tek pika 22.1 theksohen specifikat e mallit që duhet të plotësohen. Sipas formularit standard të planit të menaxhimit të kontratave specifikohet se plani i menaxhimit të kontratës është dokument i gjallë i cili përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punimeve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale.</p> <p>Te kontrata “Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse dru për ngrohje dhe Institucione tjera komunale” – me vlerë 229,950€ e lidhur me</p>	<p>Kryetari duhet te siguroje rritjen e nivelit te mbikqyrjes dhe menaxhimit te kontratave publike, duke siguruar informacion te sakte dhe te mjaftueshem rreth zbatimit te kontratave, si dhe per progresin ne zbatimin e kontratave te raportohet tek kryetari dhe te zyra e prokurimit ne baza te rregullta kohore nje apo tre mujore.</p>	<p>Zyra e prokurimit do të njoftoj me shkrim çdo menaxher të kontratës për obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga emërimi si menaxher kontrate.</p>	<p>Zyra e prokurimit dhe secili menaxher kontrate.</p>	<p>31.12.2021</p>

	<p>dt.06.10.2020, menaxheri i kontratës nuk kishte arritur të sigurojë dëshmi për cilësinë e mallrave të pranuar, e të cilat sipas kontratës duhej të inspektoheshin lidhur me lagështinë 12% dhe m3. Po ashtu, në tri pagesa të testuara me vlerë 19,011€ nuk është dokumentuar as dëshmia për prejardhjen e druve nga Agjencia Pyjor ose DUD-in doganor. Dëshmia e prejardhjes së druve sipas specifikimeve teknike në dosjen e tenderit është dashur të ofrohet së bashku me faturën e OE.</p>				
<p>5. Çështja A3</p> <p>Sigurimi i ekzekutimit të kontratës jo i plotë</p>	<p>Sipas LPP-së, neni 63 -siguria e ekzekutimit pika 1, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës. Sipas pikës 3 të këtij neni Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shumica e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi 1. i këtij neni: (i) të jetë e barabartë me së paku dhjetë përqind (10%) të vlerës së kontratës. Ky kriter ishte kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohen në rrethë strikte kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë e ekzekutimit para lidhjes së kontratës, në rrethë që të sigurohet mbarevajtja e obligimeve kontraktuale nga ana e operatoreve ekonomik.</p>	<p>Ky rekomandim është zbatuar.</p>	<p>Zyra e prokurimit</p>	<p>31.07.2021</p>
<p>6. Çështja A4</p>	<p>Tek kushtet e përgjithshme të kontratës, përkatësisht neni 34.5</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen në</p>	<p>Ky rekomandim është duke u</p>	<p>Zyra e prokurimit.</p>	<p>Gajtë gjithë vitit.</p>

<p>Mungesa e garancionit për punët e realizuara/përfunduara</p>	<p>përcaktohet se periudha garantuese e defekteve është një vit. Në pesë⁵ projekte kapitale të cilat kishin përfunduara në vitin 2020, dhe për të cilat ishin bërë pranimet teknike komuna nuk kishte kërkuar nga OE garancionin e punimeve të ekzekutuara.</p>	<p>teresi te gjitha kushtet e vendosura ne kontrate, duke aplikuar edhe deklaraten e nenshkruar nga OE per garancionin e punimeve te ekzekutuara/realizuara.</p>	<p>zbatuar në plotni.</p>		
<p>7. Çështja B2</p> <p>Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit</p>	<p>Sipas LPP-së Neni 9, pika 3 - Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale. ZKF do të siguroj që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore, ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.</p>	<p>Kryetari duhet te siguroj se do te aplikohen ne menyre strikte kerkesat ligjore ne menyre qe nenshkrimi i kontratave te behet ne perputhie me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, ne menyre qe implementimi i projekteve te realizohet ne kohe, dhe pa shpenzime shtese.</p>	<p>Ky rekomandim është duke u zbatuar. Zyra e prokurimit dhe Kryetari nuk nënshkruajnë asnjë deklaratë të disponueshmërisë së fondeve, nëse ato nuk janë të buxhetuara.</p>	<p>Zyra e prokurimit dhe Kryetari.</p>	<p>31.12.2021</p>
<p>8. Çështja A5</p> <p>Vonesë në njoftimin për nënshkrim të kontratës</p>	<p>Neni 41/A të LPP-së -Njoftimi për nënshkrimin e kontratës - përcakton: "Nëse autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, Autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do</p>	<p>Kryetari duhet te siguroje nivelin adekuat te pergjegjesise kohore te percaktuara lidhur me njoftimin per nenshkrimIn kerkesave sipas Ligjit të Prokurimit Publik.</p>	<p>Ky rekomandim është duke u zbatuar në plotni.</p>	<p>Zyra e prokurimit.</p>	<p>Gajtë gjithë vitit.</p>

	të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës.				
9. Çështja A6 Mos-mbyllja e kategorisë së investimeve në vijim pas pranimit të pasurisë	Neni 12 paragrafi 2 dhe 3 të Rreg. nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, përcakton se: “Deri në momentin e pranimit të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese do të regjistrojnë transaksion në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkë financuese.”	Kryetari duhet te siguroj se zyrtaret pergjegjes posedojne informatat ne lidhje me regjistrin e pasurise, ne menyre qe per projektet e perfunduara te finalizoj procesin e regjistrimit te pasurise.	ZKF do të sigurohet se të gjitha informatat e projekteve dhe punëve të pranuar do të barten tek zyrtari i pasurisë. Madje urët e komunikimit janë formalizuar tashmë. Në rastet kur ka mangesi në funksionim të sistemit, dhe regjistrimi i pasurisë bëhet me vonesë, zyrtarja e pasurisë do të sigurohet se do të bëjë kontroll të dyfishtë edhe nga regjistri i blerjeve.	Zyrtari-ja për rexhistrim të pasurisë dhe zyrtari i E-pasuris.	15.01.2022
10. Çështja B3 Parregullsi në menaxhimin dhe shpalosjen e pasurive në PFV	Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, te neni 6, citon që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri.	Kryetari, duhet te ndermerr masa per te siguruar se pasurite mbi dhe nen 1,000€ jane regjistruar ne regjistrat perkates, per te gjitha pasurite qe ka ne posedim ne menyre qe prezantimi i informatave ne PFV te jete i sakte dhe i plote. Njeherit duhet te siquroj qe eshte vene ne	D.Administratës së Përgjithshme ka bërë përpjekje që të regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1.000,00 €, por ka pas probleme gjatë vitit 2020 në programin për regjistrimin e E-Pasurisë.	Zyrtari-ja e pasurisë Zyrtari i E-pasuris. Komision për inventarizim.	15.01.2022

	Më tutje, neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve.	perdorim e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret ne konsiderate para perqatitjes se PFV.	Sistemi do të përdoret për aq kohë sa është funksional.		
11. Çështja B4 Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme	Komuna nuk po arrin të krijoj mekanizma për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Krahasuar me vitin paraprak 2019, LLA janë rritur për 2,556,606€ apo rreth 22%. Sfida kryesor mbetet inkasimi i tatimit në pronë në vlerë prej 6,765,214€, të hyrat nga tarifata komunale në vlerë 188,023€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 1,281,379€. Komuna kishte bërë përpjekje që të ketë një arkëtim më të mirë nga tatimpaguesit e tatimit në pronë, përmes një vendimi të mëhershëm të kryetarit. Të gjithë tatimpaguesit ishin të obliguar të paguanë një % të caktuar për borxhet e mbetura, megjithatë kjo nuk ishte reflektuar në pagesën e borxheve nga tatimpaguesit.	Kryetari, duhet te siguroje se ka forcuar kontrollet ne menaxhimin e te arketueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve ne menaxhimin dhe arketimin e tyre. Ne kete aspekt, te analizohen shkaktaret e rritjes se te arketueshrneve ne rrenyre qe te ndernnerren veprimet ligjore per mbledhjen e tyre.	Në baza mujore, Kryetari diskuton këtë dhe kërkon nga drejtëritë përkatëse ku krijojnë LI/A që të marrin masa në inkasim sa më të madh gjatë gjithë vitit përmes vërejtjetve dhe aktiiviteteve tjera.	Të gjitha drejtoritë që krijojnë LI/A.	31.12.2021
12. Çështja C2 Shpalosje jo e saktë e llogarisë së arkëtueshme	Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumata e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor	Kryetari, duhet te ndermerr masa per te siguruar se llogarite e arketueshme jane te evidentuara sakte dhe me kohe, dhe te behen prerja ne fund te vitit ne menyre qe ne kohen e perqatitjes se PVF-ve	Për të siguruar shpalosje të sakta konfirmime dhe barazime të saldove do të bëhen edhe në fund të Q-3 2021.	Drejtoritë që krijojnë LI/A.	30.09.2021

	financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.	per vitin 2020 vlera e tyre te shpaloset sakte.			
13. Çështja A7 Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm	<p>Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.</p> <p>Ne kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB dhe kemi vërejtur një zbatim të ultë të rekomandimeve. Nga 34 rekomandime të dhëna, 11 ishin zbatuar ndërsa 8 ishin në proces dhe 15 rekomandime nuk ishin zbatuar.</p>	<p>Kryetari duhet te siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshem percillen me nje proces formal te monitorimit dhe raportimit nga njesite pergjegjese dhe te njejtat rishikohen ne menyre periodike per te pare progresin e zbatimit te tyre</p>	<p>Njësia e AB në plan vjetor përfshinë ditë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve në periudhën korrik shtator. Rezultatet i dergon tek Kryetari i Komunës. Gjithashtu në plan strategjik përfshinë një auditim të vecantë për progresin e zbatimit të rekomandimeve të mëhershme.</p>	<p>Kryetari dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm ,</p>	<p>31.12.2021</p>

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivitet
- Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtoritë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI